
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

Në bazë të dispozitave të nenit 21, 44 dhe 45, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 21, paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-110 të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 20, paragrafi 6 të Udhëzimit administrativ nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II- të ndërtimeve, duke vendosur sipas kërkesës 05 nr.350/03-137946/21 dt.14.07.2021, të pronarit Valdet Shaqiri njëherit dhe investitorë përmes firmës “Luxuri Invest”sh.p.k nga Fushë Kosova, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 nr.350/02-0236302/18 dt.06.02.2019 të kushteve ndërtimore, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative me dt.12.04.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 05 nr.350/02-0236302/18 dt.06.02.2019 TË KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit 05 nr.350/02-0236302/18 dt.06.02.2019 të kushteve ndërtimore, sipas kërkesës 05 nr.350/03-137946/21 dt.14.07.2021 të pronarit Valdet Shaqiri njëherit dhe investitorë përmes firmës “Luxuri Invest”sh.p.k nga Fushë Kosova me numër të biznesit 810110635 dt.05.04.2022, për ndërtimin e ndërtesës, afariste buzë rrugës Prishtinë-Fushë Kosovë, në parcelën kadastrale nr. 10260-0 Zona Kadastrale Prishtinë, me zgjerimin edhe me parcelën kadastrale 1528-29 Z.K Prishtinë, të përfshira në Zonën Ekonomike të Planit Zhvillimor Urban.

II. Ndryshimi dhe plotësimi bazohet në Planin Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Zonë ekonomike”.

III. Ndryshimi dhe plotësimi bëhet ashtu që parcelës kadastrale nr.10260-0, me sipërfaqe 4390 m² Zona Kadastrale Prishtinë i bashkangjitet parcela 1528-29 me sipërfaqe 1054m² me qëllim të hartimit të dokumentacionit ndërtimorë për ndërtimin e aneksit dhe zgjerimin e katit të dytë të ndërtesës ekzistuese.

Sipërfaqja e parcelës ndërtimore gjithësejt do të jetë 5444 m². Ndërtesës me etazhitet 2B+S+P+2 do t'i bashkangjitet aneksi me etazhitet B+S+P+2 ashtu që kuota maksimale e aneksit të jetë e njëjtë me objektin ekzistues.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e aneksit të ndërtesës afariste, në kuadër të kësaj parcele përcaktohen duke u bazuar në parametrat urban, të përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal dhe projekt-propozimin, të prezantuar nga aplikuesi, dhe ato do të jenë:

tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Zgjidhjen Urbane, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës ekzistuese dhe aneksit është për afarizëm.
- Etazhiteti i ndërtimit të aneksit është B+P+S+2
- Qasja në parcelë duhet të realizohet nga rruga ekzistuese Aziz Abrashi.

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore me zgjerim - brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e aneksit, ndërtesës në bazë - gabarit të përdhësës ose suterren, është max.40% dhe është:

$$\text{ISHP} \dots\dots\dots S = 5444\text{m}^2 \times 0.4 = 2,177.60 \text{ m}^2$$

Baza e përdhësës ekzistuese është..... 1,756.00m²

Sipërfaqja e bazës së aneksit e lejuar për ndërtim është $2,177.60 - 1,756.00 = \underline{421.60 \text{ m}^2}$

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN) për vendosjen e ndërtesës në bazë – gabariti i bodrumit , lejohet max = 60% dhe kjo sipërfaqe është:

$$S = 5444 \text{ m}^2 \times 0.6 = 3,266.40 \text{ m}^2, \text{ për një nivel të bodrumit.}$$

Baza e bodrumit ekzistues është 2355m²

Sipërfaqja e bazës së bodrumit-aneksit e lejuar është $3,266.40 - 2,355.00 = \underline{911.40\text{m}^2}$

Sipas projekt propozimit sipërfaqja është $S=625.60 \text{ m}^2$

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas projekt propozimit, koeficientin e shfrytëzimit të parcelës dhe etazhitetin e miratuar për ndërtimin e aneksit,(B+S+P+2) do të jetë sipas pikës 2 të paragrafit III të kushteve ndërtimore dhe praktikat e miratuara nga planet tjera urbane dhe është :

ISPN..... $S = (421.60 \text{ m}^2 \times 4) = 1,686.40 \text{ m}^2$ (suterreni për pjesën e aneksit është kalkuluar si kat i plotë pasi që ~ 80% është mbi tokë).Ndërsa sipërfaqja për zgjerimin e katit të dytë të objektit ekzistues është 275 m². Gjithësejt sipërfaqe ndërtuese mbi tokë $S= 1,961.40 \text{ m}^2$

V.Bashkim i parcelave kadastrale nr.10260-0, dhe parcelës 1528-29 Zona Kadastrale Prishtinë, do të realizohet sipas zgjidhjes urbane dhe vijës rregulluese të planifikuar të përcaktuar sipas Manualit të bashkimit punuar nga kompania gjeodete e licencuar "Geomatika-Arch" SH.P.K me licencë nr.01 dt.28.07.2017.

Kjo Drejtori përmes këtij paragrafi jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale të lartë cekura, sipas Manualit të bashkimit punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtij vendimi dhe me kërkesë të pronarit/ investitorit, duke u bazuar edhe në, Planin e situacionit - "zgjidhjen urbane", e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore.

VI. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;

- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në orto-foto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës). Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohitorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

VII. Dokumentacioni ndërtimor / projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën VI., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor" dhe bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Situacioni me paraqitje të trasesë së largpërquesit 110kV dhe pozicionit të shtyllave të këtij largpërquesi.
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafo-stacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend-ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

Dokumentet të dorëzohen në tërësi sipas shtojcës "Dokumente teknike të nevojshme për aplikacionet për leje ndërtimore", e cila i është bashkangjitur këtyre Kushteve Ndërtimore.

VIII. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet

Prishtinës, për sigurimin e “Deklaratë” për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-“zgjidhja urbane” në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor- Elaborati për **Leje Mjedisore Komunale** hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
 - Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
 - Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

IX. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr.1528-29 Z.K Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit të “II-të”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – “zgjidhja urbane” dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen prej 1054 m².Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

X. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të aneksit duhet të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;

- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

XI. PAGESA E TAKSËS për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. PAGESA E TAKSËS dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

PAGESA E TAKSËS administrative do të llogaritet edhe për leje rrënimi për rrënimin e ndërtesave ekzistuese në kuadër të parcelave kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartëcekur dhe vendimit për lejimin e rrënitimit, aplikuar me kërkesë të veçantë.

PËLQIMI I NOTRIZUAR NGA FQINJËT, PËR DISTANCËN E PROPOZUAR TË NDËRTESESË I ËSHTË BASHKANGJITUR dokumentacionit në fazën e aplikimit për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore.

XII. NE FAZËN E LEJES NDËRTIMORE TE SIGUROHET PËLQIMI PRE KOSTT PER DISTANCËN E PROPOZUAR TE NDËRTIMIT prej shtyllës së largëperqesit 110kv.

XIII. KY VENDIM ËSHTË PJESË PËRBËRËSE E VENDIMIT 05 NR.350-0236302 DT.06.02.2019 për caktimin e kushteve ndërtimore dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga dita e nxjerrjes së këtij Vendimi.

-Ne fazën e aplikimit për Leje ndërtimore, parcelat që janë në hipotekë duhet të lirohen nga hipoteka ose dokumentacionit t’i bashkangjiteti pëlqimin prej bankës.

XV. VLEFSHMËRIA e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me të drejtë vazhdimi edhe për një (1) vit tjetër, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së kushteve ndërtimore.

A r s y e t i m

Aplikuesi, Valdet Shaqiri, njëherit dhe investitorë përmes firmës ‘Luxuri Invest’ sh.p.k, nga Fushë Kosova, me kërkesën 05 nr.350/03-137946/21 dt.14.07.2021, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 nr.350/02-0236302/18 dt.06.02.2019, për ndërtimin e ndërtesës afariste, në lokacionin e përshkruar në pikën I të këtij vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë aplikuesi ka prezantuar:

- Kopjen e planit dhe çertifikatën e pronësisë për parcelën kadastrale 01528-29 Z.K Prishtinë me sipërfaqe 1054m² në emër të Valdet Shaqirit.
- Kopja e planit për parcelën kadastrale nr. 10260-60 e evidentuar në çertifikatën e njësisë kadastrale nr. P-71914059-10260-0 ZK Prishtinë;
- Kopja e letërnjoftimit e Valdt Shaqirit ;
- Vërtetimi i tatimit në pronë i Valdt Shaqirit me nr.209100 dt.13.07.2021.

- Vendimin e Lejes Ndërtimore 05 nr. 351/02-149249/19 dt.07.11.2019;
- Pëlqimi LRP nr. 1163/2022 dt.21.02.2022 i Fatmir Zymberit pronar i parcelës fqinje 01528-30, qe fqiu i tij Valdet Shaqiri te ndërtoi në parcelat 01528-29 dhe 10260-0 deri ne kufi, me parcelat ku ai eshte pronar.
- Pëlqimi LRP nr. 1164/2022 dt.21.02.2022 i Fatmir Zymberit pronar i parcelës fqinje 01528-9 qe fqiu i tij Valdet Shaqiri te ndërtoi në parcelat 01528-29 dhe 10260-0 deri ne kufi, me parcelat ku ai eshte pronar.
- Pëlqimi elektroenergjetik Nr. 6669 dt.27.08.2020
- Pëlqimin nga KEDS me nr.3159 dt.15.05.2019
- Pëlqimin nga TERMOKOS, nr.497/1 dt.15.05.2019
- Pëlqimin nga ujëjellesi rajonal “PRISHTINA” NR.197191 dt.18.03.2019 ;
- Pëlqimin nga Telekom i Kosoves me nr.03-2911/19 dt.15.05.2019
- Projektin konceptual i hartuar nga “Geomatika-Arch”sh.p.k
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit e Luxuri Invest Sh.P.K me nr. 810110635 dt.05.04.2018
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit e “Geomatika –Arch” Sh.p.k me nr. 810043878 dt.28.07.2017
- Inçizimin gjeodezik të parcelave dhe pozicionimin e ndërtesës, nga “Geomatika-Arch” sh.p.k me nr. licence 01 dt.24.01.2018

Drejtoria e Urbanizmit bazuar në dokumentacionin e bashkangjitur, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, ka konstatuar se sipas nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 10,11,12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe leje ndërtimore, ka konstatuar se janë prezantuar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe është përfunduar procedura e njoftimit publik. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesëmbëdhjet (15) ditë në lokacionin në fjalë (prej 26.10.2021 deri më 09.11.2021) dhe meqenëse në ndërkohë në këtë Drejtori nuk është pranuar ndonjë vërejtje apo sugjerim, është vazhduar me shqyrtimin e kërkesës për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 nr.350/02-023630 2/18 dt.06.02.2019 në emër të pronarit Valdet Shaqiri, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, në Zonën ekonomike pranë rrugës Prishtinë - Fushë Kosovë. Gjatë shqyrtimit të “Situacionit - Zgjidhjes Urbane” me plotësime dhe ndryshime është vërtetuar se hartuesi i është përmbajtur kritereve të Planit Zhvillimor Urban të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013 ku kjo zonë është e planifikuar me destinim “Zonë Ekonomike”.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut si dhe e njëjta me rrugën “Muharrem Fejza”. Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Valdet Shaqiri, ne lagjen Zona Industriale, Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/03-137946/21 dt. 14.07.2021, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese “Aziz Abrashi” e cila rrugë është e paraparë edhe me PZHU, për ndërtesën afariste me etazhitet 2B+S+P+2, mund të pranohet si e till, marr parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës ekzistuese. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesës afariste për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas “Normave teknike të planifikimit hapësinor”, dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Kyçjet duhet të harmonizohen dhe të përshtaten me profilin e rrugës së planifikuar dhe në kohën kur realizohet ajo.

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkangjitura, identifikimit të gjendjes faktike të lokacionit në terren, ka konsultuar dokumentet e planifikimit hapësinor, për hapësirën ku gjendet lokacioni, si dhe rregullativën ligjore nga lëmi i planifikimit hapësinor dhe nga lëmi i procedurës së përgjithshme administrative, dhe si rezultat ka vendosur të miratoje ndryshimin dhe plotësimin, sipas përshkrimit në pikën I të këtij Vendimi.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidhja urbane me plotësim -ndryshim" dhe manuali gjeodezik për bashkimin e parcelave.

Udhëzim Juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-I.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie, në dosje të kësaj lënde dhe në dosje të lëndës nr. 05-350/02-0236302/18 dt. 27.09.2018.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 nr.350/03-137946/21 dt. 12.04.2022**

Zyrtari,
Mejrushe Sejdullahu



U.d. e udhëheqëses së sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi



DREJTORI,
Arben Sadiki






Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: PRISHTINË Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 10260-0-1528-29
Zona kadastrale / Katastarska zona: PRISHTINË Numri i lëndës / Broj predmeta: 11-2022 dt.10.02.2022
Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1250



1528-29 sip 1054m²

10260-0 sip 4390m²

Parcel e re 10471-0 sip.5444m²

10471-0
10260-0

Koordinatat përfundimtare

Nr	Y	X	H	Kodi	Përshkrimi	Burimi
139	7511150.289	4724283.090	604.436	11	Monoment	PM
13	7509266.624	4722771.585	595.827	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
14	7509269.673	4722759.886	596.031	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
15	7509222.283	4722743.188	595.843	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
16	7509266.509	4722776.595	595.762	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
17	7509258.619	4722775.776	595.531	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
18	7509256.023	4722774.91	595.392	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
19	7509238.542	4722772.674	595.205	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
20	7509231.781	4722771.856	595.166	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
21	7509217.234	4722767.713	595.449	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
22	7509224.056	4722743.813	596.125	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
23	7509240.293	4722681.966	599.651	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
24	7509249.163	4722646.826	599.715	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
25	7509265.573	4722653.046	601.028	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
26	7509288.555	4722662.286	599.654	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
27	7509282.953	4722678.876	599.509	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
28	7509279.333	4722697.506	598.734	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
29	7509277.363	4722708.676	598.525	6	Kunjë - shtyllë druru	PM
30	7509271.123	4722751.096	596.278	6	Kunjë - shtyllë druru	PM

Rilevoi / Snimio: "GEOMATIKA-ARCH"SHPK
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime shërbëuesit)

Nr. i licencës / Br. licence: 01

Nënshkrimi / Potpis: _____

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____



